

## **Ne lidhje me licencen e operimit te transportuesit ajror (AOL)**

Operimet kryhen zakonisht per qellime tregtare ose private. Per qellime private nje person apo nje sipermarrje nuk lejohet te kryejë fluturime per qellime perfitimi, por vetem fluturime per perdorim vetjak. Ne kete rast nuk eshte e nevojshme te leshohet nga Autoriteti I Aviacionit Civil Shqiptar Licence Operimi per Transportuesin Ajror (AOL). Kjo licence e dhene nga AACSH autorizon operatorin ajror per te kryer transport ajror te pasagjereve, te postes dhe/ose te ngarkesave sipas specifikimeve ne kete licence.

Keshtu, nese fluturimet charter do te jene ne seri, te vazhdueshme, per nje sezon apo te dy sezonet ( vere dhe dimer) dhe do te jene per qellim tregtar (fitimi) atehere do ju duhet te pajiseni me AOL, per te cilat duhet te plotesohen kriteret e percaktuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.802, date 28.12.203 “ Per miratimin e kerkesave per dhenien e licences se operimit per ofrimin e sherbimeve ajrore, procedurat, kriteret dhe kushtet per refuzimin, pezullimin apo revokimin e licences se operimit”.

a) vendi kryesor i veprimtarisë është Republika e Shqipërisë;

b)zotëron një AOC të vlefshme, të lëshuar në përputhje me vendimin nr. 1095, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave themelore në fushën e aviacionit civil”, nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose kur Shqipëria të jetë anëtare e ZPEA-së ose BE-së, në përputhje me rregulloren bazë të Bashkimit Evropian nr. 2018/1139, të lëshuar nga një autoritet kombëtar i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian apo ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe apo nga disa autoritete kombëtare të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian apo ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe ose nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë në Operim të Aviacionit;

c) ka një ose më shumë avionë në dispozicion përmes pronësisë ose marrëveshjes së qirasë së thatë – dry lease;

ç) është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me objekt kryesor të veprimtarisë transportin ajror ose transportin ajror të kombinuar me çdo operim tjetër tregtar të avionëve apo transportin ajror të kombinuar me riparim dhe mirëmbajtje avionësh;

d) struktura organizative e saj mundëson autoritetin kompetent licencues të zbatojë dispozitat e këtij vendimi;

dh) **shteti shqiptar dhe/ose shtetas të saj kanë në pronësi më shumë se 50% të sipërmarrjes** dhe e kontrollojnë efektivisht atë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një ose më shumë sipërmarrjeve ndërmjetëse, përveçse kur është parashikuar ndryshe në një marrëveshje me një shtet tjetër, ku shteti shqiptar është palë, ose kur Shqipëria të jetë shtet i BEsë ose ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, shteti i ZPEA-së ose shtetasit e shteteve të ZPEA-së, sipas parashikimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, zotërojnë dhe vazhdojnë të zotërojnë më shumë se 50% të sipërmarrjes dhe e kontrollojnë efektivisht atë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një ose më shumë sipërmarrjeve ndërmjetëse, përveçse kur është parashikuar ndryshe në një marrëveshje me një shtet jashtë ZPEAsë, në të cilën shteti shqiptar ose Bashkimi Evropian është palë;

e) plotëson kushtet financiare, të specifikuara në nenin 6, të këtij vendimi;

ë) përputhet me kërkesat për sigurimin, të përcaktuara në ligjin nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, dhe në ligjin nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;

f) provon se është në përputhje me dispozitat për reputacion të mirë, siç specifikohet në nenin 8, të këtij vendimi.

**Nderkohe ne lidhje me kushtet financiare te permendura ne germen (e) me lart 1.** Autoriteti kompetent licencues do të vlerësojë nga afër, nëse një sipërmarrje që aplikon për herë të parë për një licencë operimi mund të demonstrojë që:

a) ajo mund të përmbushë në çdo kohë detyrimet e saj aktuale dhe potenciale të ngritura sipas parashikimeve realiste, për një periudhë prej 24 (njëzet e katër) muajsh nga fillimi i operimeve; dhe

b) ajo mund të ketë aftësi paguese për shpenzimet e saj fikse dhe operative, që lindin nga operimet sipas planit të saj të biznesit dhe që janë të ngritura sipas parashikimeve realiste, për një periudhë prej 3 (tre) muajsh nga fillimi i operacioneve, pa marrë parasysh ndonjë të ardhur nga operimet.

2. Për qëllimin e vlerësimit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, çdo aplikant do të paraqesë një plan biznesi për të paktën 3 (tre) vjetët e operimit. Plani i biznesit gjithashtu do të përcaktojë hollësisht lidhjet financiare të aplikantit me çdo veprimtari tjetër tregtare, në të cilën aplikanti është i angazhuar ose direkt ose nëpërmjet sipërmarrjeve të lidhura me të. Aplikanti gjithashtu duhet të sigurojë të gjithë informacionin përkatës, veçanërisht të dhënat e përmendura në pikën 1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi. 3. Pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk do të zbatohen në një sipërmarrje që aplikon për një licencë operimi, me qëllim mbulimin e operimeve me avion me më pak se 10 (dhjetë) tonë masë uljeje maksimumi (MTOM) dhe/ose më pak se 20 (njëzet) vende. Sipërmarrje të tilla do të tregojnë se kapitali i tyre neto është të paktën 100 000 (njëqind mijë) euro ose do të sigurojnë, kur kërkohet nga autoriteti kompetent licencues, të gjithë informacionin përkatës për qëllimin e vlerësimit të përmendur në pikën 1, veçanërisht, të dhënat e përmendura në pikën 1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi. Megjithatë, autoriteti kompetent licencues mund të zbatojë pikat 1 dhe 2, të këtij neni, në një sipërmarrje që aplikon për një licencë operimi nën dispozitat e kësaj pike, që ka si qëllim të kryejë shërbime ajrore të programuara ose xhiroja e së cilës i kalon 3 (tre) milionë euro në vit. AOL leshohet menjehere pas leshimit të AOC.

Nese ka dicka per te cilen keni nevojte per me shume sqarime lutemi na shkruani

#### **Sektori i operimeve (OPS) ju ben me dije si vijon:**

Lidhur me certifikimin e operatorit ajror, jeni te lutur ti referoheni URDHËR Nr. 80, datë 30.6.2023 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KËRKESAT TEKNIKE DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE PËR OPERIMET AJRORE dhe specifikisht:

a) Pa cenuar udhëzimin e ministrit nr. 17, datë 2.9.2010, “Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore”, që përaftron rregulloren EU nr. 1008/2008, para se të fillojnë

operimet ajrore për transport tregtar, operatori do të aplikojë për të marrë një Certifikatë të Operatorit Ajror (AOC) të lëshuar nga AAC-ja.

b) Operatori duhet të japë informacionin e mëposhtëm tek AAC-ja:

- 1) emrin (e tij) zyrtar dhe emrin e biznesit, adresën dhe adresën postare të aplikantit;
- 2) një përshkrim të operimit që propozohet, ku përfshihen tipi/at, dhe numrin e
- 3) avionit që do të operojë;
- 4) një përshkrim të sistemit të menaxhimit, përfshirë strukturën organizative;
- 5) emrin e drejtorit të përgjithshëm;
- 6) emrat e personave të emëruar sipas kërkesave të ORO.AOC.135 (A) së bashku me kualifikimet dhe eksperiencën e tyre;
- 7) një kopje të manualit të operimeve sipas kërkesave të ORO.MLR.100;
- 8) një vërtetim, ku të tregohet që të gjitha dokumentet e dërguara tek AAC-ja janë verifikuar nga aplikanti dhe janë në përputhje me kërkesat e aplikuara.

c) Aplikantët duhet t'i tregojnë Autoritetit të Aviacionit Civil, që:

1) ata janë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e shtojcës V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit

civil", e këtij aneksi (Pjesa-ORO), aneksit IV (Pjesa-CAT) dhe aneksit V (Pjesa-SPA) të kësaj rregulloreje dhe aneksit I (Pjesa 26) të rregullores "Për përcaktimet shtesë të vlefshmërisë ajrore sipas

llojit të operimeve" transpozim i rregullores (BE) 2015/640 "Për përcaktimet shtesë të vlefshmërisë ajrore sipas llojit të operimeve".

2) të gjithë avionët që operojnë kanë një certifikatë të vlefshmërisë ajrore (CofA), në përputhje me urdhrin e ministrit përgjegjës për transportin nr. 326, datë 29.8.2019, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit", që përaftron rregulloren EU nr. 748/2012 ose janë marrë me qira të thatë, në përputhje me ORO.AOC.110 (d); dhe

3) organizimi dhe menaxhimi janë të përshtatshme dhe përpunohen siç duhet me shkallën dhe fushëveprimin e operimit

Keto janë kërkesa të permbledhura të procesit, i cili duhet të ketë një kërkesë nga aplikanti minimalisht 90 ditë para datës së qellimit të nisjes së operimeve.

### **Sektori i vlefshmërisë ajrore (SAW) ju ben me dije si vijon :**

-Lidhur me kërkesën e ardhur me ane të postës elektronike, Sektori i Vlefshmërisë Ajrore ka në fushëveprimin e tij regjistrimin e avionit dhe lëshimin e certifikatave: të regjistrimit (CofR), të vlefshmërisë ajrore (CofA), të rishikimit të vlefshmërisë ajrore (ARC), certifikatën e Zhurmës(NC) dhe Mode-S.

-Gjithashtu sektori i Vlefshmërisë Ajrore duhet të bëjë pranimin e organizatave Part-145(pergjegjese për mirembajtjen e avionit) dhe Part-CAMO(pergjegjese për vazhdueshmerine e vlefshmërisë ajrore të avionit), si dhe manualët e respektive të organizatave.

-Për ushtrimin e këtyre detyrave bazohemi në Kodin Ajror të Republike së Shqipërisë Nr. 96/2020, në VKM Nr. 1095/2020, në Urdhrin e Ministrit Nr. 115/2022, në Urdhrin e Ministrit Nr. 57/2024 dhe në Urdhrin e Ministrit Nr. 79/2024, linkun e të cilëve mund ta aksesoni nëpërmjet faqes zyrtare të AAC-së (<https://www.aac.gov.al/ligje-2/>).

-Për sa i përket kostove të regjistrimit, certifikatave të leshuara, miratimit të manualeve, etj., zbatohet Urdhri i Ministrit Nr. 2225/2013 "Për caktimin e tarifave të shërbimeve në Aviacionin Civil".

